




Pranuar më:	13.04	20 21
Priljeno:		
Njësia Jednica	Numri Broj	Shtojca Dodatak
01-400-01-19079		



Komuna e Lipjanit
Opština Lipljan
Municipality of Lipjan

Bashkësia Islame e Kosovës
Këshilli i Bashkësisë Islame-Lipjan

Komuna e Lipjanit e përfaqësuar nga Kryetari i Komunës z. Imri Ahmeti në tekstin në vijim:
(Komuna)

dhe

Këshilli i Bashkësisë Islame dega në Lipjan përfaqësuar nga Kryetari i Këshillit, dega në Lipjan z. Zaim Bahtiri.

Në kuadër të autorizimeve sipas Vendimit të Kuvendit të Komunës së Lipjanit për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit të qytetarëve me vendbanim të përhershëm në territorin e Komunës së Lipjanit me 15Nr.400-15449 të datës 17.03.2021, lidhin këtë:

MARRËVESHJE MIRËKUPIMI **PËR SUBVENCIONIMIN E SHPENZIMEVE PËR SHËRBIMET E VARRIMIT**

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i lidhjes së kësaj Marrëveshje është që Komuna e Lipjanit të subvencionojë kryerjen e shërbimeve të varrimit për qytetarët me vendbanim të përhershëm në Komunën e Lipjanit në shumë prej 210 € (dyqind e dhjetë euro) për secilin rast të vdekjes nëpërmjet Këshillit të Bashkësisë Islame dega në Lipjan i cili kryen shërbimet e varrimit sipas rregullave dhe traditave përkatëse konform Vendimit të Kuvendit të Komunës 15Nr.400-15449 të datës 17.03.2021.

Neni 2

Lënda

- 1.Shërbimet e varrimit përfshijnë: lajmërimet, pastrimin e kufomës, qefinin, mbulesën e kufomës, dërrasat, piramidën , hapjen e varrit dhe kryerjen e riteve fetare.
- 2.Subvencionimi i shërbimeve të varrimit, sipas kësaj Marrëveshje në asnjë mënyrë nuk ndërlihet me pagesën e anëtarisë ndaj Bashkësisë Islame.

Neni 3

Obligimet e Bashkësisë Islame

1. Këshilli i Bashkësisë Islame në baza mujore më së largu me datën 5 të muajit vijues parashtron kërkesën për kompenzim të shërbimeve përkatëse të cilën kërkesë ia drejton Zyrës së Kryetarit të Komunës.
2. Kërkesës së cekur në paragrafin e parë duhet ti bashkëngjitet:
 - 2.1 Regjistri i personave të vdekur për muajin përkatës,
 - 2.2 Aktvdekjet (duhet të përfshihet në mes tjerash edhe nënshkrimi i njërit nga anëtarët e familjes së ngushtë të personit të vdekur).

Neni 4

Obligimet e Komunës së Lipjanit

1. Komuna e Lipjanit duke u bazuar në kërkesën dhe dokumentacionin tjetër të bashkëngjitur me Vendim të Kryetarit të Komunës nëpërmjet Drejtoratit për Buxhet dhe Financa ekzekuton pagesën më së largu brenda afatit 10 ditor (ditë pune) nga dita e pranimit të kërkesës në kushte dhe rrethana normale .

Neni 5

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Palët pajtohen në mes veti që në rast të paraqitjes të ndonjë mosmarrëveshje gjatë zbatimit të saj, çështjet të zgjidhen me mirëkuptim e në rast kontesti mosmarrëveshjet do të zgjidhen në Gjykatën kompetente.

Neni 6

Numri i kopjeve

Marrëveshja e Mirëkuptimit është nënshkruar në dy kopje origjinale për secilën palë nënshkruese.

Neni 7

Hyrja në fuqi

Palët nënshkruese janë pajtuar që kjo marrëveshje e mirëkuptimit të fillon të zbatohet nga dita e nënshkrimit.

Imri Ahmeti

Kryetar i Komunës së Lipjanit



Zaim Bahtiri

Kryetari i Bashkësisë Islame Lipjan



2021